



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Politikave dhe Programeve Ndërkombëtare

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË

TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETET FRANCEZE,

VITI AKADEMIK 2014-2015

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se, për vitin 2014-2015, materialet e aplikimit për pranimin paraprak të kandidatëve të huaj në ciklin e parë të studimeve (universitete dhe shkollë arkitekturë) në Francë, mund të tërhiqen pranë zyrave të Shërbimit të Bashkëpunimit dhe Veprimit Kulturor të kësaj Ambassade, duke filluar nga data deri **16 dhjetor 2014** deri në **22 janar 2014**, çdo ditë, nga e hëna në të enjte, ora 14:00-17:30.

Mbas dorëzimit të dokumentacionit, aplikantët do t'i nënshtrohen një provimi lidhur me njohjen e gjuhës frënge (TCF), i cili do të organizohet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në datën **10 shkurt 2014**, nga ora 9:00-13:00. Ky provim është i detyrueshëm për të gjithë aplikantët, me përjashtim të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe dhe nxënësve që kanë nivelin DELF B2 dhe DALF C. Në momentin e dorëzimit të dosjes së regjistrimit, kandidati që do të kalojë testin TCF DAP duhet të paguajë 65 €.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit (e cila realizohet në gjuhën frënge), studentët shqiptarë që dëshirojnë të ndjekin studimet në ciklin e parë universitar në Francë, t'i referohen adresave online në vijim:

http://www.ambafrance-al.org/IMG/pdf/Procedure_d_inscription_2014.pdf

<http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html>

<http://www.archi.fr/ECOLES/>

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE